



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:185153

Datë: 18.01.2024

Numri i dokumentit: 05205486

PPP.nr.471/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen përmbaremore të kreditorit të përmbaremit: N.P “Termokos” Sh.a Prishtinë rr., ndaj debitorit të përmbaremit: B.R. nga P..., me adresë ..., për pagesën e borxhit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbaremit të ushtruar kundër urdhrit mbi caktimin e përmbaremit P.nr... të datës 28.07.2023 të përmbaremit privat F.B. si organ përmbaremit, jashtë seance me datës 16.01.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit të përmbaremit: B.R. nga P..., dhe shfuqizohet urdhri mbi caktimin e përmbaremit P.nr.... të datës 28.07.2023, të përmbaremit privat F.B. si organ përmbaremit, për shumën prej 252.80€ të kërkesës objekt i përmbaremit.

II. REFUZOHET SI I PABAZUAR, prapësimi i debitorit të përmbaremit: B.R. nga P..., sa i përket kërkesës objekt i përmbaremit në shumën prej 129.29€, dhe për këtë shumë urdhri mbi caktimin e përmbaremit P.nr.... të datës 28.07.2023, mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Përmbauesi privat F.B. si organ përmbaues, me Urdhër P.nr.... të datës 28.07.2023, e ka caktuar përmbauesin në këtë çështje përmbaues në bazë të dokumentit të besueshëm- Kartela e klientit, numër ... e datës 28.07.2023, pas vlerësimit se dokumenti i besueshëm përbën bazën juridike dhe paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21, 29 pika 1.2, i përshtatshëm për përmbaues sipas nenit 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përmbaues Nr.04/L-139 të Republikës së Kosovës.

Kundër urdhrit të përmbauesit privat mbi caktimin e përmbauesit P.nr.... të datës 28.07.2023, në afat të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përmbauesit me arsyetimin se borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën 31.10.2020 e deri me 30.04.2022 shihet qartë se ka arritur afatin e parashkrimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 360 par.1 të LMD-së. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim dhe të miratohet në tërësi prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbaues P.nr.... i datës 28.07.2023, si dhe ti bartë të gjitha shpenzimet e procedurës.

Me përgjigjen në prapësim, kreditori i përmbauesit, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të përmbauesit me arsyetimin se, prapësimi i debitorit është vetëm sa për prolongim të procedurës, dhe debitori në prapësim është thirrur në parashkrim, mirëpo kreditori insiston që borxhi është periodik dhe debitori në fjalë ka mbetje të borxhit për periudhën që është kërkuar dhe se borxhi duhet të paguhet për shërbimet e ofruara. Tutje ka shtuar se, debitori është thirrur në parashkrim vetëm bazuar në nenin 360 par.1 të LMD-së, duke e anashkaluar pikën 2 të po këtij nenin, ku i jep të drejtë kreditorit që të kërkojë borxhin deri me datë 31 dhjetor të vitit kalendarik që nënkupton se borxhi për

vitin 2022 mund të kërkohet deri me 31.12.2023, pra për periudhën 01.01.2022 deri më 30.04.2022 për shumën 129.29€ nuk është parashkruar. Bazuar në faktet e lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i ushtruar kundër urdhërit për përmbarrim të anulohet dhe borxhi të ekzekutohet.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit të përmbarrimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit të përmbarrimit duhet të aprovohet pjesërisht si i bazuar dhe ka vendosur si në pikën një të dispozitivit, pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar të realizohet me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditori i përmbarrimit propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datë 28.07.2023, ndërsa sipas nenit 360.1 të LMD-së është rregulluar se: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake” parashkruhen pas kalimit të një viti, ndërsa, sipas paragrafit 2 të njëjtit neni është rregulluar se: “afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”. Sipas par.2 të LMD-së, rrjedhimisht kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë para datës 31.12.2021 në shumën prej 252.80€, dhe se i njëjti nuk ka afuara asnjë provë- dokument që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në diapozitivin e këtij aktvendimi.

Kjo edhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës të krijuar me aktgjykimin Rev.nr.148/2012 të dt:09.09.2013, me të cilin është sqaruar situata se: “borxhi për shpenzimin e energjisë elektrike është borxh periodik meqë i njëjti arrin pas përfundimit të çdo muaji, dhe afati 1 vjeçar i paraparë në nenin 378 npar.1 pika 1 të LMD për parashkrim rrjedh për secilin muaj pas momentit të përfundimit të atij muaji, që do të thotë se parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Si në pikën dy të dispozitivit, gjykata vendosi pasi pretendimet në prapësim të debitorit të përmbarimit, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhrit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e asaj që u tha më lart, dhe në bazë të nenin 73 paragrafi të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.471/2023, datës 16.01.2024

Gjyqtari

Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit në dorëzim, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.